

UDHËZIM
Nr.38, datë 23.9.2011

**PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË CIKLIN E PARË TË
STUDIMEVE ME KOHË TË PJESSHME DHE EDUKIMIN NË DISTANCË, NË
INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, NË VITIN AKADEMIK
2011-2012**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të vendimit nr.627, datë 31.8.2011 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifatat e shkollimit për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, në vitin akademik 2011-2012”, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.241, datë 31.3.2011 “Për kryerjen nga Posta Shqiptare sh.a., të shërbimeve postare, financiare dhe shërbimeve të tjera, që janë në përputhje me veprimtarinë e kësaj poste, për institucionet e qeverisjes qendrore e vendore, institucionet e tjera publike, si dhe shoqëritë tregtare me kapitale shtetërore”,

UDHËZOJ:

1. Pranimin e aplikantëve në programet e studimit të ciklit të parë, në formën e studimit me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2011-2012, në bazë të përzgjedhjes së bërë nga institucionet publike të arsimit të lartë, sipas kriterëve të përcaktuara dhe të bëra publike paraprakisht. Kriteret duhet të jenë të afërta me ato që respektohen për pranimin në programet respektive me kohë të plotë. Nuk pranohen aplikime nga kandidatë të shpallur fitues me formularët A2 dhe A3, të regjistruar në listat përfundimtare.

Kuotat e miratuara me vendimin nr.627, datë 31.8.2011 të Këshillit të Ministrave do të përdoren:

a) në masën 80% për studentë që nuk janë regjistruar në asnjë program studimi ose nuk kanë përfunduar një të tillë në IAL-të publike, me kohë të plotë ose të pjesshme;

b) në masën 20% si program i dytë studimi për kandidatë që kanë përfunduar një program studimi universitar.

2. Njësitë kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë organizojnë procesin e pranimin dhe të regjistrimit të aplikantëve në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme dhe të edukimit në distancë. Procesi të monitorohet nga rektoratet dhe Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

3. Institucionet publike të arsimit të lartë të shpallin menjëherë hapjen e procedurës së aplikimit të kërkesave për kandidatët që dëshirojnë të vijnë në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë. Këto njoftime të bëhen publike në median e shkruar dhe elektronike nga institucionet publike të arsimit të lartë.

4. Aplikimi për regjistrin në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme, të bëhet pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore ku kandidati duhet të paraqitet personalisht dhe të dorëzojë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Fotokopje të noterizuar të diplomës së Maturës Shtetërore dhe certifikatës së notave, ose të ndonjë dëftese/diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barasvlershme me të në Shqipëri. Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara vitit 2011, të dorëzojnë fotokopje të noterizuar të dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme;

b) Dokument identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë) dhe fotokopje të tyre. Në dosje të mbahet fotokopja e kartës së identitetit ose e pasaportës;

- c) 2 fotografi;
- d) Mandat arkëtimi i tarifës së regjistrimit prej 1 500 lekë, paguar në Postën Shqiptare;
- e) Deklaratë që vërteton se kandidati nuk ndjek ndonjë program tjetër studimi me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme në institucionet e arsimit të lartë publik.

5. Në qoftë se kandidati nuk ka diplomë të Maturës Shtetërore apo dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesë dublikatë të saj të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme dhe të vërtetuar në drejtorinë arsimore rajonale/zyra arsimore përkatëse, ose listën e notave të shkollës së mesme lëshuar nga Arkivi i Shtetit.

6. Kandidatët që do të aplikojnë për regjistrim në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë, në një program të dytë studimi, të dorëzojnë në sekretariatë mësimore, përveç dokumentacionit të pikës 4, edhe diplomën e lëshuar nga një institucion i arsimit të lartë (ose fotokopje të saj të noterizuar), diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit (ose fotokopje të saj të noterizuar), të vlerësuar e barasvlershme me të në Shqipëri.

7. Kandidatët që do të aplikojnë për regjistrim në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë, në Universitetin e Sporteve të Tiranës, përveç dokumentacionit të pikave 4 dhe 5 të këtij udhëzimi, duhet t'u nënshtrohen edhe kritereve të veçanta (konkurseve të pranimit), të vendosura nga ky institucion, për pranimet në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë, të bëra publike paraprakisht.

8. Institucionet publike të arsimit të lartë, duke filluar nga data 14.10.2011, të shpallin në vende të dukshme datat dhe oraret e veprimeve të aplikimit dhe të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për regjistrim, si edhe njoftime të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecursë normale të procesit të pranimeve në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë.

9. Aplikimi i kandidatëve në programin e studimit me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë, të zhvillohet nga data 17.10.2011 deri në datën 21.10.2011, prej orës 8:00 deri në orën 16:00, pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë.

10. Institucionet publike të arsimit të lartë të shpallin dhe të afishojnë listat e kandidatëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, brenda orës 16:00 të datës 27.10.2011, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës.

11. Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë ku janë shpallur fitues, të zhvillohet nga data 1.11.2011 deri në datën 6.11.2011, prej orës 08:00 deri në orën 16:00, pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë.

12. Regjistrimi i kandidatëve fitues të bëhet vetëm me diplomën e Maturës Shtetërore dhe dëftesën e pjekurisë origjinale të shkollës së mesme, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 5 të këtij udhëzimi. Dokumentet e kandidatëve jofitues t'u kthehen personave kundrejt kërkesës.

13. Pas mbylljes së procesit të regjistrimit, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në Agjencinë Kombëtare të Provimeve (AKP) listat përfundimtare të kandidatëve fitues të regjistruar, për të marrë numrin e matikulimit. Kandidatët që rezultojnë të regjistruar në programe të tjera studimi të ciklit të parë, ose të dytë, me kohë të plotë apo të pjesshme, në IAL-të publike, nuk marrin numër matikulimi. AKP-ja pas verifikimit i kërkon IAL-ve t'i çregjistrojë ata.

14. Aplikimi dhe regjistrimi i kandidatëve për transferim studimesh kryhet pas shpërndarjes nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, të kuotave të përcaktuara në shkronjën "c" të pikës 1 të vendimit nr.627, datë 31.8.2011 të Këshillit të Ministrave, sipas përcaktimeve në statutet dhe rregulloret e IAL-ve publike.

15. Regjistrimi i kandidatëve nga Republika e Kosovës, për kandidatët shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit, si dhe për shtetasit e huaj, sipas shkronjës "ç" të pikës 1 të vendimit nr.627, datë 31.8.2011 të Këshillit të Ministrave, që do të studiojnë në institucionet publike të

arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme dhe edukim në distancë, kryhet pas dërgimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës të urdhrin të shpërndarjes së kuotave të përcaktuara me vendimin nr.627, datë 31.8.2011 të Këshillit të Ministrave.

16. Kandidatët nga Republika e Kosovës dhe kandidatët shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit aplikojnë pranë institucioneve publike të arsimit të lartë. Përzgjedhja e fituesve bëhet sipas pikës 1 të këtij udhëzimi brenda kuotave të parashikuara në urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës për shpërndarjen e kuotave të pranimit për këta kandidatë. IAL-të të pranojnë kandidatë nga Republika e Kosovës dhe nga trojet jashtë kufijve të vendit edhe në ato raste kur nuk janë parashikuar kuota për to, pasi këta kandidatë do të konsiderohen në rishpërndarjen e kuotave.

17. Ngarkohen Zëvendësministri, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS

Myqerem Tafaj